



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MIRDITË

Rreshen ,më 09.07.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – MALLRA”

OBJEKTI I PROCEDURËS:

BLERJE USHQIME PËR INSTITUCIONET ARSIMORE, BASHKIA MIRDITË

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi sipas FPP- 15884000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/ Vlera e prishme e kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **4 083 333 leke (katërmilion e tetëdhjetetremije e treqind e tridhjetë)**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- 2.1.1 Në rastin kur operatorët ekonomik nuk kanë detyrim ligjor të liçensohen nga QKB duhet të paraqesin Ekstraktin Tregtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurohet.
- 2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001. Çertifikata të jetë e lëshuar

nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, që vërteton cilësinë e menaxhimit të sigurisë së ushqimit ISO 22000. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a dhe 2** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:... c) aftësinë teknike dhe profesionale;... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”

Gjithashtu në **nenin 44** “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), përcaktohet se, citojmë:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Duke qënë se standartet ISO 9001 dhe ISO 22000 janë të zbatueshëm për të gjitha subjektet që marrin pjesë në zinxhirin ushqimor, si: prodhuesit e ushqimit, prodhuesit e paketimit ushqimor, tregtarët e ushqimit etj., Njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me *garantimin e cilësisë së produkteve në mënyrë të qëndrueshme* (ISO 9001), si dhe *garantimin e sigurisë ushqimore në zinxhirin ushqimor* që kryen ofertuesi (ISO 22000).

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës në vazhdimësi.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëqoftëse Operatorët Ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023 dhe 2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, *ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
c) **40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.**

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik :

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (neni 55/4/b i vkm-se 285/2021)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Kjo pikë përmbushet me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 4** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. **Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të

deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.”

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm...”

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:... b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 40 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.

2.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë pjesë të stafit, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë, të paktën një person të certifikuar për « Trajtimin, perpunimin, shpërndarjen e produkteve shtazore dhe joshtazore », për të cilin duhet të paraqiten kontrata e punës e vlefshme, dokumenti që provon certifikimin e mesipërme, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një numër minimal prej 2 (dy) punonjësish të punësuar, ndër të cilët 1 (një) shofer dhe 1 (një) punonjës për transportin e mallit, të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesa për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, në rastin kur automjeti i deklaruar është në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur automjeti disponohet me qera, punonjësi shofer i kërkuar mund të jetë i kontraktuar.

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme, si dhe
- Leje për drejtimin e mjetit kategoria B, të punonjësit me detyrë “shofer”.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale ambiente të përshtatshme për tregtimin dhe magazinimin e mallrave të kërkuara (objekt kontrate) si dhe me ambient frigoriferik, e pajisur me leje Higjeno-sanitare, dhe çertifikatë DDD e vlefshme. **(Ambjenti do të vëzhgohet nga Autoriteti Kontraktor)**

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira, automjet (ATP) me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të automjetit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

- a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:
 - *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*
 - Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*
 - Kontratë huaje.
 - *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
 - Kontratë qiraje.
- b) Leje qarkullimi e mjetit.
- c) Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
- d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,
- e) Çertifikate për transport mallrash, për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, automjet (ATV) (frigorifer) për artikujt **bulmet, salçiçe, fileto pule**, ku të jetë i pajisur me gjurmues të temperaturës së mjetit gjatë periudhës së transportit (tahograf temperature) me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të automjetit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

- a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:
 - *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*
 - Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*
 - Kontratë Noteriale Huapërdorje (me kohëzgjatje në përputhje me afatin e M. Kuadër)
 - *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
 - Kontratë Noteriale Qiraje (me kohëzgjatje në përputhje me afatin e M. Kuadër)

- b) Leje qarkullimi e mjetit.
- c) Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
- d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,
- e) Çertifikate për transport mallrash, për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg
- f) Foto e dukshme të mjetit bashkë me targat (të paktën 2).

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Raport Analize origjinale ose kopje të noterizuar, lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës, për produktet e ofruara objekt prokurimi, ku në të duhet të jetë shënuar emri i produktit ose një e dhënë tjetër që tregon se lidh këtë raport analize me produktin e ofruar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ai duhet të paraqesë vetdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore. (Rekomandim nr.10181 dt.19.11.2018 AKU-APP)

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin me anë të cilit vërtetohet se subjekti i tij është i inspektuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore. (Rekomandim nr.10181 dt.19.11.2018 AKU-APP)

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare **dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.** Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5, 6 dhe 8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, **kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre**

dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: ... c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në “Relacion për perlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike...” dërguar nga Komisioni, ku ndër të tjerash, bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik¹”, dhe nenin 40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 22.07.2024, ora 10⁰⁰**, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT